

20191822880

## **AGJENCIA TEKNIKE OPERATIVE – SHKUP**

Në bazë të nenit 3 paragrafët (5) dhe (6), nenit 6 dhe nenit 32 të Ligjit për Agjencinë Teknike Operative (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” numër 71/2018 dhe 98/2019) dhe nenit 35 paragrafi (4), nenit 68 paragrafët (2) dhe (9) dhe nenit 74 të Ligjit për ndjekjen e komunikimeve (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” numër 71/2018 dhe 108/2019), drejtori i Agjencisë Teknike Operative Shkup miratoi:

### **RREGULLORE PËR MËNYRËN E VEPRIMIT TË OPERATORËVE GJATË ZBATIMIT TË MASAVE PËR NDJEKJEN E KOMUNIKIMEVE DHE MËNYRËN E KRYERJES SË MBIKËQYRJES PROFESIONALE NGA ATO-JA**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Lënda e rregullimit**

###### **Neni 1**

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e veprimit të operatorëve gjatë zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve dhe mënyra e kryerjes së mbikëqyrjes profesionale nga ATO-ja, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Agjencinë Teknike Operative (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për ATO-në) dhe Ligjit për ndjekjen e komunikimeve (në tekstin e mëtejshëm: LNK).

##### **Obligimet e operatorëve**

###### **Neni 2**

Operatorët kanë për detyrë t’i sigurojnë të gjitha kushtet e domosdoshme teknike për të mundur ndjekjen e komunikimeve në rrjetet e tyre, në pajtim me ligjin.

##### **Konstatimi dhe përcaktimi i masave dhe standardeve**

###### **Neni 3**

(1) ATO-ja i konstaton masat dhe standardet për sigurinë e informacioneve që kanë për detyrë t’i zbatojnë operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike lidhur me obligimet e tyre për zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve, në pajtim me ligjin dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje. Masat dhe standardet për sigurinë e informacioneve janë dhënë në “Rregulloren për masat dhe standardet për sigurinë e informacioneve”.

(2) ATO-ja e përcakton mënyrën në të cilën mundësohet lidhja teknike ndërmjet operatorëve dhe pajisjes ndërmjetësuese (LEIMD) të vendosur në ATO, në pajtim me ligjin dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje.

(3) ATO-ja e përcakton mënyrën e veprimit të operatorëve gjatë zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve, në pajtim me ligjin dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje.

### **Komisioni për Mbikëqyrjen Profesionale të Operatorëve**

#### **Neni 4**

Për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale të punës së operatorëve, drejtori i ATO-së, në pajtim me ligjin dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje, nga radha e punonjësve në ATO formon Komision për Mbikëqyrjen Profesionale (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), i përbërë nga kryetari dhe dy anëtarët dhe zëvendësit e tyre.

### **Nocioni i mbikëqyrjes profesionale**

#### **Neni 5**

Mbikëqyrja profesionale është monitorimi i plotë ose i pjesshëm dhe i planifikuar i punës së operatorëve lidhur me përmbushjen e kushteve teknike dhe masave dhe standardeve të zbatueshme të parashikuara me ligj dhe këtë Rregullore. Mbikëqyrja profesionale ndiqet me kontrollimin e pavarur dhe sistematik të gjendjeve që janë lëndë e mbikëqyrjes, konstatimit dhe vlerësimit të gjendjes së konstatuar.

### **Lënda dhe qëllimi i mbikëqyrjes profesionale**

#### **Neni 6**

Komisioni kryen mbikëqyrje profesionale të operatorëve të autorizuar me qëllim që të përcaktojë nëse gjatë zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve janë përmbushur kushtet teknike dhe masat dhe standardet e zbatueshme të parashikuara me ligj dhe me dispozitat nga nenet 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje.

### **Llojet e mbikëqyrjes profesionale**

#### **Neni 7**

Komisioni kryen mbikëqyrje profesionale:

- me dhe pa njoftim paraprak dhe sipas nevojës;
- drejtpërdrejt – me prani dhe kontrollim në hapësirat dhe dokumentacionin e operatorëve mbi të cilin kryhet mbikëqyrja dhe tërthorazi në hapësirat e ATO-së nëpërmjet kontrollimit në raportet dhe dokumentet tjera, dhe/ose nëpërmjet bisedës me personat që janë të ftuar nga Komisioni;
- plotësisht ose pjesërisht;
- teknike dhe të dokumentacionit;

- aktuale, ex post dhe ex ante.

## **Vendimmarrja për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale**

### **Neni 8**

- (1) Komisioni vendos të kryejë mbikëqyrje profesionale me iniciativë profesionale.
- (2) Komisioni mund të kryejë mbikëqyrje profesionale të operatorëve edhe me kërkesë të organeve të autorizuar për zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve.
- (3) Me kërkesë të trupave mbikëqyrës nga neni 35 i LNK-së, Komisioni ndihmon në kryerjen e mbikëqyrjes profesionale të operatorëve.

## **Lista e nocioneve**

### **Neni 9**

Shprehje të veçanta të përdora në këtë Rregullore e kanë kuptimin si në vijim:

(1) komunikimi është dhënia ose shkëmbimi i informacioneve midis njerëzve me të folur, tinguj, dritë, tekst të shkruar, vizatim, fotografi, send ose gjestikulacion, si dhe proces teknik i dërgimit, transmetimit dhe pranimit të çfarëdo të folur, të dhënave, tingujve, sinjaleve, tekstit të shkruar, fotografive statike dhe të lëvizshme, që shërbejnë për shkëmbimin e informacioneve midis njerëzve, midis njerëzve dhe sendeve, midis sendeve ose për menaxhimin e cilitdo send me ndihmën e sistemit të telekomunikacionit, si dhe internet-protokollit, të folurit nëpërmjet internet-protokollit, faqes së internetit dhe postës elektronike;

(2) ndjekja e komunikimeve është të kuptuarit e përhershëm të përmbajtjes së cilitdo komunikim dhe njëkohësisht të hartuarit e shkresës teknike për përmbajtjen e komunikimit, me mundësinë të riprodhohet;

(3) masat për ndjekjen e komunikimeve janë:

a) ndjekja dhe incizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike – masa e veçantë hetimore dhe

b) masat për ndjekjen e komunikimeve për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit;

(4) organet e autorizuar për zbatimin e masës së veçantë hetimore për ndjekjen e komunikimeve janë: prokurori publik dhe policia gjyqësore, të përcaktuar në pajtim me ligjin;

(5) organet e autorizuar për zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit janë: Agjencia e Sigurisë Kombëtare dhe Ministria e Mbrojtjes – Shërbimi Ushtarak i Sigurisë dhe Zbulimit, ndërsa në pjesën e spektrit të frekuencës së radiovalëve në frekuencat e larta, shumë të larta dhe ultra të larta (HF, VHF dhe UHF) organ i autorizuar për zbatimin e masës për ndjekjen e komunikimeve është Qendra e Vëzhgimit Elektronik e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut që caktohet për nevojat e mbrojtjes. Organet e theksuara janë të autorizuar t'i zbatojnë masat për ndjekjen e komunikimeve për shkak të kryerjes së punëve për të cilat janë kompetentë në pajtim me ligjin;

(6) ndjekja dhe incizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike është të kuptuarit e përhershëm të përmbajtjes së procesit teknik të dërgimit, transmetimit dhe pranimit të cilitdo të folur, të dhënave, tingujve, sinjaleve, tekstit të shkruar, fotografive statike dhe të lëvizshme, që shërbejnë për shkëmbimin e informacioneve midis njerëzve, midis njerëzve dhe sendeve, midis sendeve ose për menaxhimin e cilitdo send me ndihmën e sistemit të telekomunikacionit, si dhe internet-protokollit, të folurit nëpërmjet internet-protokollit, faqes së internetit dhe postës elektronike, përmes qasjes në pajisjen teknike të operatorëve përmes ATO-së ose me zbatimin e pajisjeve të veçanta teknike pa ndërmjetësimin e ATO-së dhe operatorëve dhe njëkohësisht krijimin e shkresës teknike për përmbajtjen e komunikimit, me mundësinë të riprodhohet;

(7) Agjencia Teknike Operative Shkup (ATO) është organ i pavarur dhe i mëvetësishëm i themeluar me ligj, që siguron lidhshmëri teknike midis operatorëve dhe organeve të autorizuar;

(8) operatorët janë operatorë të rrjetit publik të komunikimeve elektronike dhe/ose ofrues të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, të cilat komunikimin e ndjekur nëpërmjet rrjetit dhe mjeteve të komunikimeve elektronike e sigurojnë për organet e autorizuar për zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve me ndërmjetësimin e ATO-së;

(9) sistemi i regjistrimit elektronik është regjistri i cili automatikisht e ruan shkresën / logon (në tekstin e mëtejshëm: logon), në të cilën pasqyrohen aktivitetet e kryera të komunikimit të incizuar të realizuar në pajtim me ligjin. Incizimi automatik nënkupton incizimin sistematik të logove, pa ndërhyrjen e njeriut. Logot duhet të jenë të arritshme dhe të lexueshme për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollimit;

(10) pajisja ndërmjetësuese (LEIMD) është pajisja teknike ndërmjetësuese dhe mbështetja përkatëse e softuerit që e mundëson aktivizimin e masës së ndjekjes dhe incizimit të komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike;

(11) pajisja LEMF në ATO janë mjetet për ndjekjen e komunikimeve të cilat transmetohet përmbajtja e komunikimit të ndjekur dhe informacionet lidhur me komunikimin e ndjekur nga pajisja teknike e operatorëve nëpërmjet ATO-së për stacionet e punës që i posedojnë organet e autorizuar;

(12) logot janë dosje ose dosjet të cilat automatikisht krijohen, incizohen dhe ruhen në serverin në regjistrin elektronik dhe përmbajnë të dhëna për të gjitha aktivitetet që janë kryer, kur kanë filluar dhe kur kanë përfunduar, të dhënat për subjektin që i ka kryer, për cilin numër telefoni, adresën IP ose të dhënën tjetër teknike të identifikimit;

(13) personi përgjegjës për sigurinë e informacioneve është personi i cili është i punësuar në operatorët dhe është përgjegjës për parimet themelore të sigurisë së informacioneve, konfidencialitetin, integritetin dhe arritshmërinë (të njohur si triadë, shkurtimisht KIA);

(14) personat e autorizuar për funksionalitetin e LI-së janë personat e punësuar në operatorët ose te bashkëpunëtorët e operatorëve dhe të cilët janë të autorizuar nga operatorët me nivelin më të lartë të prioritetit të qasjes në elementët e tij të rrjetit nëpërmjet të cilëve mundësohet ndjekja e komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike;

(15) komunikimi i LI-së është komunikimi që ndiqet ligjërisht;

(16) fusha e LI-së është pjesë e sistemit teknik të operatorëve që në çfarëdo mënyre lidhet me procesin e ndjekjes ligjore të komunikimeve.

## II. MËNYRA E VEPRIMIT TË OPERATORËVE

### **Emërtimi dhe zgjedhja e personit përgjegjës për sigurinë e informacioneve**

#### Neni 10

(1) Operatorët kanë për detyrë të caktojnë person përgjegjës për zbatimin e masave dhe standardeve për sigurinë e informacioneve dhe zëvendës të tij.

(2) Operatorët kanë për detyrë ta dorëzojnë në ATO listën e personave përgjegjës nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Personat e zgjedhur kanë për detyrë me dorën e vet të nënshkruajnë deklarata për mbrojtjen e të dhënave personave dhe konfidencialitetin dhe dokumentet tjera të nevojshme dhe ato t'i deponojnë në ATO.

### **Caktimi i personave të autorizuar për funksionalitetin e LI-së**

#### Neni 11

(1) Operatorët kanë për detyrë të caktojnë persona të autorizuar me nivel më të lartë të prioritetit të qasjes në elementët e tyre të rrjetit (nëpërmjet të cilëve realizohet e a.q. funksionaliteti i LI-së) për komunikim me ATO-në, për arsye të funksionimit të pandërprerë dhe të vazhdueshëm të elementëve nga pajisja e rrjetit të operatorëve nëpërmjet së cilës mundësohet ndjekja e komunikimeve elektronike dhe komunikimeve tjera elektronike.

(2) Operatorët kanë për detyrë ta dorëzojnë në ATO listën e personave të autorizuar nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Personat e autorizuar për funksionalitetin e LI-së kanë për detyrë me dorën e vet të nënshkruajnë deklarata për mbrojtjen e të dhënave personave dhe konfidencialitetin dhe dokumentet tjera të nevojshme dhe ato t'i deponojnë në ATO.

### **Obligimi për certifikatën e sigurisë**

#### Neni 12

(1) Personat nga neni 10 paragrafi (1) mund të zgjidhen vetëm nëse për ta nuk ekziston rreziku i sigurisë për të marrë certifikatë të sigurisë për qasje në informacionet e klasifikuara me shkallën e klasifikimit të sigurisë – Sekret Shtetëror.

(2) Personat nga neni 10 paragrafi (1) mund të caktohen vetëm nëse për ta nuk ekziston rreziku i sigurisë për të marrë certifikatë të sigurisë për qasje në informacionet e klasifikuara me shkallën e klasifikimit të sigurisë – Tepër Konfidenciale.

(3) Kushtet për ekzistimin e rrezikut të sigurisë janë në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për informacionet e klasifikuara dhe Dekretin për sigurinë e personave përdorues të informacioneve të klasifikuara.

(4) Nëse personat nga neni 10 dhe neni 11 të kësaj Rregulloreje nuk posedojnë certifikata përkatëse dhe të vlefshme të sigurisë, ATO-ja do të iniciojë procedurë për lëshimin e certifikatave të nevojshme në organin kompetent.

## **Zbatimi i masave dhe standardeve**

### **Neni 13**

(1) Masat dhe standardet për sigurinë e informacioneve në pajtim me rekomandimet e standardeve ITU-T, ETSI dhe TISPAN operatorët kanë për detyrë t'i zbatojnë në rrjetet dhe/ose shërbimet publike të komunikimeve elektronike lidhur me obligimet e tyre për zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve në pajtim me ligjin.

(2) Masat dhe standardet për funksionalitetin e LI-së operatorët kanë për detyrë t'i zbatojnë në rrjetet dhe/ose shërbimet publike të komunikimeve elektronike lidhur me obligimet e tyre për zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve në pajtim me ligjin.

(3) Operatorët kanë për detyrë t'i zbatojnë kushtet dhe kërkesat që i parashikon rregullativa në fuqi lidhur me ndërmarrjen e masave organizative dhe teknike përkatëse për sigurimin e sekretit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe ndërmarrjen e masave dhe standardeve përkatëse për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara.

(4) Personat përgjegjës për zbatimin e masave dhe standardeve për sigurinë e informacioneve dhe personat e autorizuar për funksionalitetin e LI-së kanë për detyrë të sigurojnë zbatimin e plotë dhe të vazhdueshëm të masave dhe standardeve nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni.

## **Sigurimi i kushteve teknike për ndjekjen e komunikimeve**

### **Neni 14**

(1) Operatorët kanë për detyrë të posedojnë pajisje teknike e cila është e konfiguruar në mënyrën që pas inicimit të komandës për ndjekjen e komunikimeve nga ATO-ja, në momentin e vendosjes së lidhjes dhe shfaqjes së komunikimit midis dy ose më tepër përdoruesve të shërbimeve të telekomunikimit të operatorëve, nga të cilat të paktën një palë është përdorues për të cilin është lëshuar komandë e tillë, menjëherë krijohet sinjali i replikës nga sinjali i komunikimit origjinal, kohëzgjatja e të cilit është vazhdimisht gjatë gjithë kohës së komunikimit.

(2) Operatorët kanë për detyrë të mundësojnë replikë nga sinjali nga paragrafi (1) i këtij neni të merret në interfejsin përkatës nga ATO-ja.

(3) Sinjalin e replikës operatorët nuk guxojnë ta orientojnë drejt lokacionit tjetër fizik ose logjik në të cilën do të incizohej dhe/ose më vonë do të dërgohet në ATO, pa marrë parasysh mundësinë nëse në atë lokacionin tjetër sinjali i replikës mund të incizohet ose automatikisht të shlyhet pas dorëzimit të tij në ATO.

## **Obligimet e operatorëve lidhur me Marrëveshjen**

## **e Konfidencialitetit**

### **Neni 15**

Midis operatorëve dhe prodhuesit të pajisjes, si dhe midis operatorëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre që kanë qasje në pajisje dhe bëjnë mirëmbajtjen e saj, si dhe midis operatorëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre kur janë të punësuar personat e autorizuar për funksionalitetin e LI-së duhet të ekzistojnë marrëveshje në fuqi për konfidencialitetin dhe marrëveshje për përpunimin e të dhënave personale të lidhura në formë me shkrim, me dispozitat / kushtet e të cilave në pjesën e mundësive për ndjekjen e komunikimeve duhet të njoftohet edhe ATO-ja.

### **Lidhja dhe sigurimi i përçuesve të komunikimit dhe interfejsëve për transmetim**

### **Neni 16**

(1) Operatorët kanë për detyrë të caktojnë pikë të rrjetit të vet bashkë me ATO-në në të cilën do të realizohet lidhja e përçuesve të komunikimit që shërbejnë për transmetimin e komunikimit të LI-së nga operatorët me përçuesit e komunikimit që shërbejnë për transmetimin e komunikimit të LI-së në pronësi të ATO-së.

(2) Me kërkesë të ATO-së, operatorët në afat të arsyeshëm, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë, kanë për detyrë të vendosin aq numër të rrjeteve të interfejsit për linqet e komunikimit sa i janë të domosdoshme ATO-së që të bëjë ndjekjen e komunikimeve në rrjetin e operatorëve.

(3) Operatorët kanë për detyrë të sigurojnë nivel të arsyeshëm të masave të sigurisë fizike të hapësirave dhe pajisjes teknike me funksionalitetin e LI-së, si dhe përçues të komunikimit në pronësi të operatorëve që shërbejnë për transmetimin e komunikimit të LI-së në pikën në të cilën bëhet lidhja e ATO-së dhe operatorëve, që janë identikë me masat që operatorët i ndërmarrin për sigurimin fizik të pajisjes së tyre.

(4) Për arsye të realizimit të nivelit të nevojshëm të mbrojtjes së linqeve të komunikimit të vendosura nga ATO-ja, operatorët kanë për detyrë të mundësojnë hapësirë të domosdoshme për vendosjen e pajisjes së ATO-së dhe kushtet teknike për funksionimin normal të saj.

(5) Operatorët kanë për detyrë të hartojnë procedura operative dhe të sigurisë për mënyrën e mirëmbajtjes teknike dhe mënjanimin të defekteve lidhur me elementët e rrjetit me funksionalitetin e LI-së.

(6) Operatorët kanë për detyrë të bëjnë back up të elementëve sistematikë në fushën e LI-së dhe për të të përcaktohet procedura përkatëse operative dhe e sigurisë.

### **Transmetimi i vetëm nëpërmjet pajisjeve ndërmjetësuese të ATO-së**

### **Neni 17**

Operatorët kanë për detyrë në rrjetin e vet të sigurojnë kushte teknike me të cilat aktivizimi dhe çaktivizimi i ndjekjes së komunikimeve janë të mundura vetëm nëpërmjet pajisjeve ndërmjetësuese të cilat janë në kompetencë të ATO-së.

## **Kompresimi dhe kriptu-mbrojtja**

### **Neni 18**

Në rastin kur operatorët kanë futur kompresim ose kriptu-mbrojtje në trafikun e komunikimit, ata kanë për detyrë ta largojnë, përpara se ta dërgojnë përmbajtjen e shërbimit të ndjekur të komunikimit në ATO.

### **Ndjekja në kohë reale, arritshmëria dhe pandërprershmëria**

(1) Operatorët kanë për obligim t'i mundësojnë ATO-së transmetimin e sinjalit të ndjekjes së komunikimeve në kohë reale.

(2) Operatorët kanë për detyrë t'i sigurojnë të gjitha kushtet të cilat janë në kompetencë dhe kontrollim të tyre dhe të cilat janë informacione të domosdoshme lidhur me komunikimin e ndjekur të jenë në dispozicion menjëherë pas përfundimit të komunikimit, ndërsa ndjekja e komunikimit të ndërpritet për gjithë kohëzgjatjen e saj.

### **Njëkuptimshmëria në ndjekjen e komunikimeve**

### **Neni 20**

(1) Operatorët kanë për detyrë të sigurojnë lidhje të saktë dhe të njëkuptimshme të informacioneve lidhur me komunikimin e ndjekur me përmbajtjen e komunikimeve që ndiqet, për shkak të pamundësisë të ndjekjes masive.

(2) Operatorët kanë për detyrë menjëherë ta njoftojnë ATO-në se nuk kanë mundësi teknike të sigurojnë njëkuptimshmëri në ndjekjen e komunikimeve.

### **Ndërprerja e ndjekjes së komunikimeve**

### **Neni 21**

(1) Në rastin e ndërprerjes së linkut / sinjalit midis operatorëve dhe ATO-së, operatorët kanë për detyrë ta njoftojnë ATO-në.

(2) Nëse ndërprerja është planifikuar në mënyrë përkatëse për aktivitete të caktuara në anën e operatorëve, nevojitet 24 orë paraprakisht që ajo të njoftohet në ATO, ndërsa pas përfundimit të aktiviteteve të dorëzohet raporti në ATO.

(3) Nëse ndërprerja nuk është planifikuar dhe problemi është në anën e operatorëve, ato kanë për detyrë në afat më të shkurtër kohor ta zgjidhin problemin dhe brenda 3 (tre) ditëve nga zgjidhja e problemit të dorëzojnë raport në ATO.

### **Pandryshueshmëria e cilësisë dhe sigurisë së shërbimit të komunikimeve**

### **Neni 22**



(1) Operatorët duhet të sigurojnë që personi, komunikimet e të cilit ndiqen ose personi tjetër i paautorizuar mos të vërehet çfarëdo ndryshimi në cilësinë e shërbimit të komunikimeve që mund të shkaktohet me zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve. Funkcionimi i shërbimit të ndjekur të komunikimeve duhet të mbetet i pandryshuar për personin, komunikimet e të cilit ndiqen.

(2) Operatorët duhet të ofrojnë siguri dhe cilësi të njëjtë ose më të madhe të shërbimit të ndjekur të komunikimeve se siguria dhe cilësia e shërbimeve të komunikimeve të cilat i mundësohen personit, komunikimet e të cilit ndiqen.

(3) Siguria e komunikimit të ndjekur në kuptim të paragrafit (2) të këtij neni nënkupton edhe krijimin e sinjalit të replikës së komunikimit gjithnjë kur përdoruesit në rrjetin e operatorëve do ta vendosin komunikimin, si dhe orientimin e sinjalit drejt pajisjes LEMF të ATO-së.

### **Sigurimi i llogarive të përdoruesit (user dhe password)**

#### Neni 23

(1) Operatorët kanë për detyrë të sigurojnë llogari mjaft të kontrolluara të përdoruesit në pajisjen, me të cilat do të pamundësohet aktivizimi, çaktivizimi dhe kontrollimi i ndjekjes së komunikimeve nga personat që kanë qasje për shkak të mirëmbajtjes teknike.

(2) Operatorët kanë për detyrë të përcaktojnë procedura operative dhe të sigurisë gjatë krijimit dhe mundësimin të llogarisë së përdoruesit të ATO-së me privilegje të caktuara në pajtim me Procedurën e veçantë për menaxhimin e llogarive të përdoruesit me nivel të qasjes në funksionalitetin e LI-së nga sistemet në rrjetin e tij, të përkufizuar me dokument të veçantë.

(3) ATO-së i mundësohet në mënyrë të pavarur ta menaxhojë llogarinë e përdoruesit (user dhe password) për provizionim në elementët e rrjetit me funksionalitetin e LI-së në anën e operatorëve.

### **Sistemi i regjistrimit elektronik**

#### Neni 24

(1) Operatorët kanë për detyrë, në pajtim me specifikimin e dorëzuar nga ATO-ja, të zbatojnë sistem të regjistrimit elektronik në të cilin automatikisht ruhet kopja identike nga logot e LEIMD-së në ATO.

(2) Ruajtja automatike e kopjeve identike të logove nga paragrafi (1) i këtij neni ka të bëjë me gjithë periudhën kohore derisa zgjat ndjekja e komunikimit.

(3) Regjistrat nga paragrafi (1) i këtij neni operatorët kanë për detyrë t'i mbajnë në mënyrën me të cilën sigurohet autenticiteti i logove pa mundësinë për ndryshimin e tyre.

(4) Logot nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të jenë të arritshme dhe të rilexueshme për qëllimet e kontrollimit dhe për nevojat e hetimit penal.

(5) Logot nga paragrafi (1) i këtij neni shlyhen pas skadimit të periudhës kohore prej 10 vite, të llogaritur nga momenti i krijimit të tyre.

## **Njoftimi për ndryshimet teknike**

### Neni 25

(1) Për të gjitha ndryshimet që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe elementët e rrjetit dhe/ose konfiguracionin e tyre, operatorët kanë për detyrë ta njoftojnë ATO-në përpara se ta bëjnë ndryshimin, si në vijim:

1) Për ndryshimet në rrjetin e operatorëve që tërheqin investime nga ATO-ja në pajisjet LEIMD dhe LEMF, operatorët kanë për detyrë ta njoftojnë ATO-në më së voni deri në fund të qershorit në vitin rrjedhës për ndryshimet të cilat planifikohen të aktivizohen në rrjetin e operatorëve në vitin e ardhshëm;

2) Për ndryshimet në rrjetin e operatorëve me të cilat nevojiten ndryshime në konfiguracionet e pajisjes në kompetencë të ATO-së (plotësimet e softuerit, etj.), operatorët kanë për detyrë ta njoftojnë ATO-në të paktën 1 (një) muaj përpara realizimit të ndryshimit në rrjetin e operatorëve;

3) Për ndryshimet në rrjetin e operatorëve me të cilat nuk parashikohen ndryshime të pajisjes në kompetencë të ATO-së, ndërsa nevojitet ATO-ja të bëjë kontrollim në funksionalitetin e LI-së, operatorët kanë për detyrë ta njoftojnë ATO-në të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara realizimit të ndryshimit në rrjetin e operatorëve.

(2) Komunikimi midis operatorëve dhe ATO-së zhvillohet në pajtim me Procedurën për monitorimin dhe shmangien e pengesave të elementëve të rrjetit nëpërmjet të cilave mundësohet ndjekja e komunikimeve, të përkufizuar në dokument të veçantë "Procedura për paraqitjen dhe administrimin e ndërhyrjeve teknike".

### **III. MËNYRA DHE PROCEDURA E KRYERJES SË MBIKËQYRJES PROFESIONALE NGA ATO-JA**

#### **Vazhdimësia e mbikëqyrjes profesionale**

### Neni 26

(1) Operatorët kanë për detyrë të mundësojnë kushte përkatëse për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale nga Komisioni.

(2) Operatorët kanë për detyrë t'i mundësojnë Komisionit inspektim në qasjen dhe mbi përdorimin e pajisjes teknike dhe përçuesve elektronikë të komunikimit që shërbejnë për lidhjen e ATO-së dhe operatorëve, inspektim në dokumentacionin dhe në aktivitetet që ndërmerren për zbatimin e masave dhe standardeve për sigurinë e informacioneve, për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara.

#### **E drejta e qasjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes profesionale**

### Neni 27

Për nevojat e kryerjes së mbikëqyrjes profesionale, ATO-ja ka të drejtën e qasjes së drejtpërdrejtë në hapësirat dhe elementët e rrjetit me funksionalitetin e LI-së që ndodhen tek operatorët.

## **Qasja në logot elektronikë**

### **Neni 28**

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes profesionale, Komisioni ka të drejtën e qasjes në logot e incizuar dhe ato i jepen në formën dhe në mënyrën në të cilën mund të bëhet krahasimi.

## **Qasja në shkresat e aplikacionit dhe sistematike**

### **Neni 29**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes profesionale, Komisioni ka të drejtën e qasjes në shkresat e aplikacionit (log fajlet) në të cilat regjistrohen aktivitetet lidhur me mundësimin teknik të ndjekjes së komunikimeve të cilat krijohen nga operatorët dhe ato përdoren për qëllimet e kontrollimit dhe janë me regjimin mjaft të kontrolluar të qasjes.

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes profesionale, Komisioni ka të drejtën e qasjes në shkresat sistematike (alarm log fajlet) të cilat krijohen për nevojat e mirëmbajtjes teknike dhe mënjanimin e defekteve të sistemeve me funksionalitetin e LI-së dhe ato përdoren për qëllimet e kontrollimit dhe janë me regjimin mjaft të kontrolluar të qasjes.

(3) Operatorët kanë për detyrë që Komisionit t'i dorëzojnë në inspektim procedurën e përcaktuar të sigurisë për kryerjen e back up të elementëve sistematikë në fushën e LI-së.

## **Mbikëqyrja në sigurinë e informacioneve**

### **Neni 30**

Komisioni kryen mbikëqyrje profesionale në zbatimin e masave dhe procedurave për sigurinë e informacioneve në pajtim me ligjin.

## **Raporti për mbikëqyrjen e kryer profesionale**

### **Neni 31**

(1) Pas mbikëqyrjes së kryer profesionale, Komisioni harton Raport për punën e operatorëve në të cilin përmbahen sugjerimet për punën e operatorëve lidhur me gjendjen dhe përdorimin e pajisjes teknike dhe përçuesve elektronikë të komunikimit që shërbejnë për lidhjen e ATO-së dhe operatorëve.

(2) Komisioni e dorëzon Raportin nga paragrafi (1) i këtij neni në operatorët brenda 3 (tre) ditëve pas zbatimit të mbikëqyrjes.

(3) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet në Komisionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Masave për Ndjekjen e Komunikimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në Agjencinë për Komunikime Elektronike, për informim.

(4) Operatorët kanë për detyrë pa anulim të vepronë sipas konstatimeve dhe sugjerimeve të Komisionit të theksuara në Raport.

#### IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

##### Neni 32

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit, ndërsa do të zbatohet nga dita e botimit të saj në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 10-478/1  
27 gusht 2019  
Shkup

Drejtör,  
**Zoran Angellovski, d.v.**